



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR
SEKTORI JURIDIK

Nr.601/Iprot.

Shkodër, më 14.05.2018

LËNDA: Lidhur me vendimin Nr.23 datë 30.04.2018 të Këshillit të Bashkisë Shkodër.

DREJTUAR: KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR.

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që i jep ligji nr.107/2016, dt. 2.10.2016 "Për Prefektin", neni 56 i KPAD, shqyrtoi vendimin nr.23 datë 30.04.2018 të Këshillit të Bashkisë Shkodër "Për miratimin e kërkesës për dhënje me qira sipërfaqe kullimore verore prej 1 Ha me afat 10 vjet, ndodhur në ekonominë kullimore Ekonomia Rosek Rrjoll, parcela nr.3, Njësia Administrative Postribë dhe miratimin e kontratës Tip për dhënje me qira".

Sa më sipër Prefekti në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 9, pika 1/1.2/a, neni 27, pika 5, neni 54, pika e, neni 55, pika 4, ligjit Nr. 9693 datë 19.3.2007 "Për fondin kulloror" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.433 datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive", shtojca 46, Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit nr.2 datë 20.07.2016 "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dënujen e tyre për kullotje e kositje bari, kreu II, pika 7, germa b, pika 8, 9 dhe 12, VKB Shkodër nr. 4 datë 30.01.2018 "Për miratimin e listës së kullotave të gatshme për kullotje e kositje për sezonin veror", ju autorizon të procedoni konform procedurave të metejshme ligjore.

Në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.433 datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive", nr. rendor 1993 emëtohet RosRrjoll dhe jo Rosek Rrjoll.

Ju sjellim në vëmendje në nenin 10 të kontratës bashkëngjitur vkb duhet shtuar pika 11 e Krcut III të Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit nr.2 datë 20.07.2016 "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dënujen e tyre për kullotje e kositje bari".

Tregoni vëmendje në respektimin e nenit 23, pika I, të ligjit Nr. 9693 datë 19.3.2007 "Për fondin kulloror" i ndryshuar.

Me respekt,

VENDI ME UDHEZIME SHKRESA, KËRKESA
 NR. 74/18 DATE 17.05.2018
 BERSHËR
 10000

PREFEKTI
 Cesk MILLIJA





BASHKËTIA
SHKODËR

REPUBLIKA E SHqipërisë

14993
Nr. Prot

Shkodër, më 14.09.2018

KONTRATË

PËR DHËNIE ME QIRA TË KULLOTAVE DHE LIVADHEVE PËR KULLOTJE E KOSITJE BARI

E lidhur sot më datë . . . 2018 , ndërmjet palëve si më poshtë :

QIRADHËNËSI : Bashkia Shkodër , me adresë Rr : « 28 Nëntori » përfaqësuar nga Kryetari i saj Zj. Voltana ADEMI në vijim « Qiradhënësi »

QIRAMARRËSI : z. Zamir Sait Milani fermer me nr. Personal H70116033E dhe NIPTI I.86408131S përfaqësuar nga z. Zamir Sait Milani në vijim "Qiramarrësi"

Baza ligjore

- Ligji nr.7850 datë 29.07.1994, "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar
- Ligji nr. 9693, datë 19/03/2007, "Për Fondin Kulloror" i ndryshuar
- VKM nr.632 datë 11.6.2009, "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje"
- Udhëzimin e Ministrisë Mjedisit nr.2, datë 20.7.2016, "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari"
- VKB nr. 4 datë 30.01.2018 "Lista e Kullotave të gatshme për kullotje e kositje për sezonin veror"
- VKB nr 23 datë 30.04.2018 " Për miratimin e kërkesës për dhënie me qira sipërfaqe kullorore verore prej 1 ha me afat 10 vjet, ndodhur në Ekonominë Kullorore Rrosek Rejoll Parcela nr 3 NJA Postribë dhe miratimin e kontratës tip për dhënie me qira"

Adresa: Rr. 13 Llybren, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiaeshkodere.gov.al, e-mail: info@bashkiaeshkodere.gov.al

Neni 1

OBJEKTI I KONTRATËS

“Qiradhënësi” jep me qira për kullotje, për ndërtime provizore « qiramarrësit » kullotën verore me sipërfaqe të kërkuar për shfrytëzim prej 1 (një) ha që ndodhet në ekonominë kullosore « Rrethek Rrjoll », Njësia Administrative Postribë, në parcelën nr 3 me sipërfaqe totale 88.7 ha dhe me kapacitet mbajtës prej 66 krerë sipas kërkesës për 20 krerë të imta, sipas hartës bashkëlidhur kësaj kontrate, dhe koordinatave :

Nr	X	Y
1	4383508	4667259
2	4383420	4667251
3	4383385	4667288
4	4383385	4667364
5	4383417	4667442
6	4383472	4667453
7	4383519	4667405
8	4383552	4667404
9	4383516	4667333
10	4383488	4667315

Neni 2

AFATI I KONTRATËS

Afati i kontratës është 10 vjet.

Kjo kontratë fillon efektet juridike dhe financiare nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Shkodër.

Neni 3

VLERA VJETORE E QIRASË

Vlera vjetore e qirasë për përdorimin e kullotave është llogaritur sipas tarifave të miratuara nga Vendimi i Këshillit të Ministrave, nr.632 datë 11.6.2009 « Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje » si më poshtë:

Për dhentë krerë nr. krerësh 20 x 100 lek/krere = 2000 lek/krerë

Vlera vjetore e qirasë për përdorimin e tokës për ndërtime provizore, është llogaritur sipas tarifave të miratuara nga Vendimi i Këshillit të Ministrave, nr.632 datë 11.6.2009 « Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje » si më poshtë:

Adresa: Rr. "13 Dhjetori", Nr 7, Shkodër, 0601 / www.bashkeshkoder.gov.al / e-mail: info@bashkeshkoder.gov.al

Qendër stani e rrethuar, m² sip 20 x 50 lekë/m²= 1000 lek

Ngrehinë banimi për barinj, m² sip 15 x 50 lek/m² = 750 lek

Qiramarrësi detvrohet t'i paguajë qiradhënësit detyrimin, në vlerën prej 3750(tremijë e shtatëqind e pesëdhjet) lek.

Neni 4

PAGESA DHE REGJIMI I SAJ

Pagesa e qirasë bëhet parapagim për 3 vitet e para dhe këstet e tjera i paguam në vitet pasardhëse në atë datë kur është lidhur kontrata, kjo përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë nr.2 datë 20.07.2016, pika 17 gërma (d).

Pagesa e qirasë do të bëhet për llogari të Institucionit (Bashkia Shkodër) sipas Faturës për Arkëtim.

Neni 5

GJUHA E KONTRATËS

Gjuha e kontratës është gjuha shqipe.

Neni 6

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRADHËNËSIT

Qiradhënësi detyrohet t'i dorëzojë qiramarrësit, menjëherë mbas lidhjes së kësaj kontrate, sipërfaqen sipas hartës me kufijte e saj, që do të përdoret për kullotje/ kosiqe hari dhe përdorimin e tokës për ndërtimet provizore nga fermeri/subjekti.

T'i vaktobjë në vënd, në rast se ka, parcelat që do të përmirësohen dhe parcelat eksperimentale të cilat sipas udhëzimit nuk lejohen të kullohen. Në këto parcela do të mbahen proces – verbale me kufij të qartë.

Dorëzimi bëhet me proces-verbal dorëzimi midis përfaqësuesit të Qiradhënësit dhe Qiramarrësit direkt në objekt, mbas nënshkrimit të kësaj kontrate.

Qiradhënësi ushtron kontrolle (nga struktura përgjegjëse në Bashki Shkodër, Drejtoria Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave) në çdo kohë mbi zbatimin e kushteve të kësaj kontrate dhe mbi pasurinë e dhënë me qira për të përcaktuar nëse qiramarrësi respekton detyrimet kontraktore, si dhe ato detyrime që dalin për qiramarrësin sipas natyrës dhe rregullave agroteknike të përdorimit të objektit të kontratës.

Në çdo rast kontrolli, qiradhënësi mban në vënd një procesverbal dhe i kërkon qiramarrësit riparimin e shkeljeve të dëmeve të konstatuara.

Qiradhënësi kryen sondazhe gjatë periudhës së kullotjes , për të mos lejuar asnjë rast të futjes së bagëtive në kullotë mbi kapacitetin kulloror të kontraktuar.

Qiradhënësi nuk përgjigjet për pretendime të tjera që nuk kanë të bëjnë me objektin dhe qëllimin e kësaj kontrate.

Neni 7

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRAMARRËSIT

Qiramarrësi është i detyruar që në çdo rast t'u përmbahet kërkesave teknike të përdorimit të fondit kulloror për kullotje, sipas Kreu III, i Udhëzimit të Ministrisë nr.2, datë 20.7.2016, "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kostije bari".

Madhësia e brezave të ndarjes së kullotës nga fermeri të përlogaritet në raporte të drejta me kapacitetin dhe ditë-kullotjet në mënyrë të tillë që bagëtia të kullojë në secilin prej tyre jo më shumë se 5-6 ditë. Rikthimi i tufës në brezin e parë të kullotur bëhet pas 15-20 ditësh.

Ndërprerja e kullotjes së brezit bëhet kur lartësia e barit të rritet pas kullotjes të jetë rreth 4-5 cm.

Koha e fillimit të kullotjes përcaktohet në kontratë sipas gjendjes konkrete së bimësisë të kullotës e livadhit:

për kullotjen e bagëtive të imëta kur lartësia e barit të ketë arritur 8-10 cm;

Largimi i tufave të bagëtive nga kullota bëhet kur mbaron periudha e kontratuar ose kur verifikohet nga qiradhënësi se lartësia e barit në gjithë sipërfaqen e kullotjes është nënë 4 cm.

Për nevoja personale, qiramarrësi lejohet të mbajë në kullotë derrë e shpendë me numër të kufizuar dhe 2-3 kafshë ngarkese (aq sa i nevojiten për plotësimin e nevojave për ushqimine njerëzve që shkojnë me bagëti dhe transportin e ngarkesave). Numri i derrave, shpendëve dhe kafshëve të ngarkesës shkruhen në kontratë dhe mbahen të kontrolluar pranë staniit.

Qiramarrësi çdo vit kur kryen pagimin e kështit, bashkëlidhur me mandatpagesën dorëzon edhe certifikatën veterinarë të cilën e merr nga shërbimi veterinar. Certifikata veterinarë i hushkëngjitet kontratës dhe një kopje mbahet në stan për t'u paraqitur autoriteteve të shërbimit veterinarë në rast kontrolli.

Mbas nënshkrimit të kësaj kontrate Qiramarrësi merr në dorëzim me proces-verbal kullotën/livadhin sipas kuljive të hartës, apo edhe objektet ndihmëse lerat për ujë të pijshëm



për blegtorinë dhe objektet e tjera në shërbim të kullotës në qoftë se ka dhe në rast dëmtimi të tyre, detyrohet t'i riparojë ato pa pagesë.

Qiramarrësi ka të drejtë të mbajë në kullotë bagëtitë e tij, vetëm sipas afësisë mbajtëse të kullotës dhe të zbatojë rregullat për përdorimin e kontrolluar të kullotës.

Të kryejë pa shtëpëllim zbrazjen e lërës, (kur ajo është me saraçineskë), pastrimin e saj dhe pasta; të blloktojë rrjedhjet e ujit, për t'u mbushur për sezonin e ardhshëm në prezencë të inspektorit të zonës.

Të marrë të gjitha masat e nevojshme për ruajtjen e kullotave nga zjarret.

Qiramarrësit që shkaktojnë zjarre në kullotat dhe livadhet, veç detyrimeve financiare që paguajnë për dëmin e shkaktuar, humbasin edhe të drejtën për vazhdimin e mëtejshëm të kontratës.

Të zbatojë të gjitha rregullat e shërbimit veterinar dhe shëndetësor për bagëtitë të cilat kullojnë në kullotën objekt i kontratës.

Të paguajë vlerën e qirasë sipas kësteve të përcaktuara në nenet 3 dhe 4 të kësaj kontrate.

Të lehtësojë kontrollat që mund të ushtrohen nga ISHMPUT për përdorimin e kullotës së marrë me qira.

Qiramarrësi nuk ka të drejtë të jap me nënqira kullotën apo livadhin objekt të kësaj kontrate, apo të bëjë nënkontrata me subjekte të tjera, ose t'ia kalojë kontratën e lidhur një subjekti tjetër.

Në përfundim të afatit kontraktor, qiramarrësi i dorëzon qiradhënësit me procesverbal dorëzimi të mbajtur direkt në objekt, sipërfaqen objekt të kontratës.

Në se qiramarrësi ka plotësuar të gjitha detyrimet, kullota është trajtuar sipas parimit të menaxhimit të qëndrueshëm dhe kriterëve teknike, deri në përfundim të afatit 10-vjeçar të kontratës, është këshillë bashkiak që të rishikojë mundësinë e përsëritjes së kontratës dhe lidhjen e një kontrate të re.

Qiramarrësi është i detyruar të kryejë investimet sipas planit të investimeve të paraqitur të cilat ka marrë përsipër për të kryer.

Qiramarrësi përgjigjet për humbjen dhe dëmtimet e sendit të cilat ndodhin gjatë kontratës së qirasë.

Qiramarrësi mbas përfundimit të kontratës është i detyruar ta kthejë sendin në të njejtën gjendje si e ka marrë.



Neni 8
KOMUNIKIMI

Çdo komunikim midis palëve do të bëhet me shkrim.

Neni 9
NJOFTIMET

Çdo njoftim, kërkesë apo çdo lloj komunikimi ndërmjet palëve do të bëhet sipas mënyrës së përcaktuar në kontratë, njoftimi i palëve do të bëhet me shkrim për problemet që mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate.

Neni 10
ZGJIDHIJA E KONTRATËS

Kontrata zgjidhet me mbarimin e afatit, si çka me marrëveshje midis palëve.

Kontrata mund të zgjidhet edhe përpara mbarimit të saj, vetëm kur janë shkelur dhe nuk janë respektuar kërkesat e saj nga secila palë. Konkretisht, qirachënësi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kësaj kontrate, kur qiramarrësi nuk ka shlyer vlerën e qirasë sipas kushteve të kontratës, dëmton ose nuk mirëmban kullotën/livadhin ose veprat ujëpërse për blegtorinë (lera çezma etj) që ka marrë në përdorim, nuk përmbush detyrimet e tjera që rrjedhin nga kontrata.

Njoftimi për zgjidhjen e kontratës bëhet me shkrim 15 ditë përpara zgjidhjes së kontratës.

Për shkeljen e kushteve kontraktore, kur ato janë parashikuar si kundravajtje administrative sipas nenit 34 të ligjit Nr.9693 datë 19.03.2007", Për fondin kullësor", i ndryshuar, ndaj qiramarrësit vendosen sanksionet e parashikuara nga ky nen.

Në rast se kullota digjet, qiramarrësit i humbet e drejta e përdorimit të kullotës për gjithë periudhën e mbetur.

Neni 11
DISPOZITA TË FUNDIT

Mosmarrëveshjet gjatë zbatimit të kësaj kontrate, zgjidhen me mirëkuptimin e palëve; në të kundërt ato zgjidhen në Gjykatën e rrethit gjyqësor të rrethit Shkodër.

Pjesë e kontratës janë :



- Kërkesa e subjektit me gjeneralitetet përkatëse si edhe dokumentat shoqëruese të kërkesës.
- Harta e objektit (Parcelat,n/parcelat) e kullorës Verore.
- Proces-Verbali i dorëzimit të objektit sipas kufijëve përkatës ku shënohen veprat ujëmbajtëse (Ierat,ndertimet,rrugët e brendshme etj) nëse ka .
- Plani i biznesit,
- Projekti mbareshkrimi i kullotave

Çdo korigjim i kontratës së qirasë pas nënshkrimit të saj e bën atë të pavlefshme.

Kjo kontratë qiraje u hartua në 4(kater) kopje origjinale e cila pasi u lexua palëve, u pranua dhe u nënshkrua me vullnetin e tyre të plotë e të lirë, një kopje origjinale ju dorëzua Qiramarrësi .

PALËT

QIRAMARRËSI

Përfaqësuesi

ZAMIR MILANI



QIRADHËNËSI

Bashkia Shkodër

Kryetari



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
DHOMA NOTERISE SHKODER

Nr. rep. 3556

Tarifa 3.500 leke
Tvsh 20% 700 leke
Pulla 200 leke
Shuma 4.400 leke



VERTETIM NENSHKRIMESH



Ne Dhomen e Noterise Shkoder, dhe para meje noter Arben Salim KOPLIKU, me seli ne Shkodër, Bulevardi "Zog I", pall, 1, me 14 Shtator 2018 (dymijë e tetëmbëdhjetë), u paraqiten vullnetarisht:

1. Bashkia Shkoder, me seli ne Shkoder, Rruga "28 Nentori", perfaqsuar nga krytarja Voltana Vehbi ADEMI, dt. 30 Shtator 1974, lindur e banues ne Shkoder, rruga "Arra e Madhe", nr. 59.
2. "Zamir Milani" Fermer, rregjistruar ne Tatim Taksa me NIPT L864081315, perfaqsuar nga Zamir Sait Milani, dtl 16 Janar 1977, lindur e banues ne Domen, Njesia Administrative Postribe, Bashkia Shkoder. Me nr leternjoftimi 027651462 dhe nr vetjak H70116033E.

per identitetin e Krytares se Bashkise, jam i njohur personalisht, ndersa per Zamir Milani, u njoha ne baze te dokumentit te tij personal qe paraqiti, madhore e me te gjithë aftesite e kerkuara nga ligji, sipas kërkesës, vërtetoj nënshkrimet e mesiperme ne kontraten per dhenie me qira te kullotave dhe livadheve per kullotje dhe kositje bari, nenshkrime te cilat jane vene ne pranine time si noter :

Arben Salim KOPLIKU
NOTER

REPUBLICA E SHQIPERISE

Milani

Zog Iri

Shqiptare/Albanian

Domen, Shkoder

16-01-1977

28-09-2003

H8

027651462

28-09-2019

H70116033E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr. 1 Shkodër, web: www.bashkiaeshkodere.gov.al e-mail: info@bashkiaeshkodere.gov.al Tel: +35522400100

Numri i praktikës: 4637
Datë: 15/02/2018

KËRKESË

Unë i nenshkruari Zamir Sait Milani, fermer me NIPT L864081315, me numër personal H70116033E, banues në Domen, Njesia Administrative Postribe, Shkodër dhe numër celulari 0673805880 në bazë të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" dhe Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë i drejtohem Drejtorisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujërave të Bashkisë Shkodër me kërkesën e mëposhtme:

KËRKOJ

Marrje me qira, sipërfaqe kollosore per kullotje bagetish verore, ndodhur ne ekonomine kullosore Rošek-Rrjoll, parcela nr.3. Siperfaqja qe kerohet eshte 1 (nje) ha. Lloji i bagetive dele, gjithesej 20. Afati i marrjes me qira, 10 vjet. Brenda, kesaj siperfaqe kerkoj te ndertoj stan dhe kasolle, si dhe lere uji per bagetite. Bashkefidhur nodhen, Nipt fermeri, vertetimi i sistemit informacionit blegtoral dhe veterinar, leshuar nga eksperti veterinar, vertetimi nga njesia administrative dhe karta e identitetit.

Aplikanti

Përgjegjësi i Zyrës me Një Ndalesë

Zamir Milagi

Gjergj Kurti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

NUMRI SERIAL: 40150272704



40150272704

ÇERTIFIKATË REGJISTRIMI

Personit të Tatueshëm:

Femër Zamir Sait Milani

Me adresë kryesore:

Fshati Domen, Nj. Administrative Postribe, Shkoder

I jepet ky numër identifikimi (NIPT/SSN):

L86408131S

DATA E LËSHIMIT: 08.07.2018

Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkoder



Kjo certifikatë është pranë e Ministrisë së Financave dhe shërben si detyrues në qoftë se ka ndryshime në datë ose numër identifikimi të tatueshmit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Njesia Administrative Postribre

Adresa: Rr. 13 Diftovë, Nr. 7 Shkodër, web: www.bashkiashtodër.gov.al, e-mail: info@bashkiashtodër.gov.al, Tel: +35520401150

Nr. 263 Prot



Numri i praktikës: 4619


Datë: 15-02-2018

VËRTETIM

Me anë të të cilit vërtetojmë se: Z. Zamir Sait Milani, me numër personal H70116033E, i datëlindjes 16-01-1977, është banor i fshatit Domen, Njesia Administrative Postribre, Bashkia Shkodër.

Ky vërtetim lëshohet sipas kërkesës së të interesuarit.

Punonjësi i Gjendjes Civile


Gjendja Civile Postribre

ADMINISTRATOR

Altin Shabaj



Në mungesë dhe me urdhër

Ad. Shoqëror

Dashamir SHABAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRIE



Milani
Zarrir
Shqipëri/Albanian
Deris, S. Skoder
16-01-1977
29-09-2009
MB

027651452



M
28-09-2019
H70116033E





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M
Nr. 23, datë 30.04.2018

PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR DHËNIE ME QIRA SIPËRFAQE KULLOSORE VERORE PREJ 1 HA ME AFAT 10 VJET, NDODHUR NË EKONOMINË KULLOSORE-EKONOMIA ROSEK RRJOLL PARCELA NR. 3, NJËSIA ADMINISTRATIVE POSTRIBË DHE MIRATIMIN E KONTRATËS TIP PËR DHËNIE ME QIRA

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e datës 30.04.2018, me propozim të kryetarit të bashkisë, mbështetur në nenet 8 pika 2, 9 pika 1/1.2 shkrorja "a", 27 pika 5, 36, 54 shkronja "e", 55 pika 4 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kulloros", të ndryshuar, VKM nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive", Udhëzim nr. 2, datë 20.07.2016 i Ministrisë së Mjedisit "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje dhe kositje bari", pika 7, VKB nr. 4, datë 30.01.2018 të Këshillit Bashkiak Shkodër "Për miratimin e listës së kullotave të gatshme për kullotje e kositje për sezonin veror", relacionit të Drejtorisë së mjedisit, pyjeve dhe administrimit të ujërave,

V E N D O S I :

1. Dhënia e përqimit për dhënie me qira sipërfaqen kullosore verore me sipërfaqe prej 1 (një) ha, ndodhur në ekonominë kullosore- Ekonomia Rosek Rrjoll, parcela nr. 3, njësia administrative Postribë, me afat 10 (dhjetë) vjet dhe miratimin e kontratës Tip sipas lidhjes bashkëngjitur.
2. Harta për parcelën/nën parcelën dhe kontrata Tip janë pjesë integrale e këtij vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.